



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 29.06.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit të Bordit të Drejtorëve 01 nr.06-38833-11/3 i dt: 10.06.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e ZKKK-së e cila është e ndërlidhur me kërkesën e z.Ramadan Maliqi nga Gjakova për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për strehimin e familjes së tij , me dt: 29.06.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e cila është e ndërlidhur me kërkesën nr. 16-400-37697 e dt:03.06.2015, e parashtruar nga z. Ramadan Maliqi nga Gjakova për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së banesës në vlerë prej 100€ në muaj, sipas kriterit të vazhdimit të kontratës 6+6 muaj, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të ZKKK në vlerën totale prej 600€ .

2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej 100€ në muaj për periodën prej 6 muajve, sipas kërkesës së ZKKK-së të dt:08.06.2015, kërkesës së z. Ramadan Maliqi nr.16-400-37697 dhe Përfundimit 01 nr. 06-38833-11/3 i dt:03.06.2015 .

3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 100€ në muaj, përkatësisht vlerën totale prej 600€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e qiradhënësit z.Lulzim Asani nga Gjakova, nr. 1140160568000116 ProCredit Bank.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

5. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z.Ramadan Maliqi nga Gjakova
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila